



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA E PËRGJITHSHME  
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

URDHËR

Nr. 74, datë 29.02.2016

**“Për një ndryshim në rregulloren Nr.78, datë 16.04. 2010 “Për kryerjen e inspektimit dhe fillimin e procedimit disiplinor””**

Në mbështetje të Ligjit Nr.8737, datë 12.02.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), neni 8, pika 2, paragrafi “gj”, pas njohjes me mendimin e Këshillit të Prokurorisë,

**URDHËROJ:**

Në rregulloren nr.78, datë 16.04. 2010 “Për kryerjen e inspektimit dhe fillimin e procedimit disiplinor bëhet ky ndryshim:

**Neni 1**

Në nenin 6, pika 1 paragrafi “a” ndryshohet si më poshtë:

**“a- Inspektim i përgjithshëm**, i cili zhvillohet mbi bazën e planifikimit vjetor të miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm. Ky lloj kontrolli realizohet jo më pak se një herë në tre vjet për çdo prokuror të prokurorive prane gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit dhe ka si synim njohjen dhe evidentimin e cilësisë së akteve të prokurorit, si dhe problematikave të hetimit, ushtrimit të ndjekjes penale, përfaqësimit të akuzës dhe ekzekutimit të vendimeve penale.

a.1-Për prokurorët që ushtrojnë funksionet pranë gjykatave të shkallës së parë, ky lloj inspektimi kryhet duke përzgjedhur në mënyrë rastësore 10 % të:

- fashikujve të mosfillimit të procedimeve penale;
- fashikujve të pushimit të procedimeve penale;
- materialeve që lidhen me kërkesat për caktimin e masave të sigurimit;
- kërkesave për gjykim;
- konkluzioneve përfundimtare;
- ankimeve ndaj vendimeve të gjykatës së bashku me fashikujt përkatës;
- materialeve që lidhen me ekzekutimin e vendimeve penale.

a.2 Për prokurorët që ushtrojnë funksionet në prokuroritë pranë gjykatave të apelit, ky lloj inspektimi kryhet duke përzgjedhur në mënyrë rastësore 10 % të:

- fashikujve që lidhen me konkluzionet përfundimtare të paraqitura nga prokurori para gjykatës së apelit;
- fashikujve që lidhen me përkrahjen e ankimit të prokurorit të shkallës së parë;
- fashikujve që lidhen me rekursat .

Përfshihen nga përzgjedhja në mënyrë rastësore rastet e heqjes dorë të prokurorit të apelit nga ankimet e prokurorëve të shkallës së parë si dhe rastet kur prokurori i apelit ka përkrahur ankimin e të pandehurit, kontrolli i të cilave kryhet i plotë.

a.3 Kur prokurori që inspektohet pretendon se fashikujt e përzgjedhur nuk janë tregues të cilësisë së veprimtarisë së tij profesionale, ka të drejtë të kërkojë menjëherë pas përzgjedhjes së fashikujve të kontrollohen jo më pak se gjysma e fashikujve të përzgjedhura nga shorti rastësor, sipas parasikimit në shkronjën “a.1” të këtij neni, të cilat i zgjedh vetë.

a.4 Përzgjedhja, për sa të jetë e mundur, duhet të sigurojë kontrollin e të gjitha llojeve të çështjeve sipas grupveprave penale të shqyrtuara nga prokurori”.

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

**PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**ADRIATIK LLALLA**

